

Ky është botimi i dytë i buletinit të ANTEA-s, i cili paraqet një pamje të përgjithshme të projektit të saj, që ka të bëjë me ndërtimin dhe funksionimin nga Grupi TITAN të një fabrike të re për prodhimin e çimentos, pranë Tiranës. Për më shumë se dy vite, rreth 2000 persona në Shqipëri dhe jashtë saj kanë punuar për të përmbushur këtë nismë. Nëpërmjet këtij buletini, ne kemi si qëllim t'ju informojmë mbi zhvillimet që janë bërë në lidhje me projektin ANTEA dhe në të njëjtin kohë ftojme aktorët e përfshirë në këtë projekt të japin opinionin e tyre. Për këtë arsye, ky buletin mundësohet edhe në formën elektronike në faqen tonë të internetit www.anteacement.com.




- 1 Pak fjalë rreth projektit të ANTEA-s
- 1 Përfitimet nga projekti i ANTEA-s
- 2 Ndërtimi i një fabrike të re për prodhimin e çimentos
- 4 Siguria, kujdesi për mjedisin dhe angazhimi i grupeve të interesit të përfshirë në këtë projekt

Pak fjalë rreth projektit të ANTEA-s

Projekti ANTEA është një nga investimet më të mëdha industriale në Shqipëri që ka si qëllim ndërtimin dhe funksionimin e një fabrike për prodhimin e çimentos, e aftë të prodhojë një total prej 1.5 ton çimento në vit, e cila

ndodhet pranë Fushë Krujës. Investimi i ri pritet që jo vetëm të ulë nevojën për importimin e çimentos në vend por nxit gjithashtu investimet e reja dhe në veçanti zhvillimin e ndërtimit të banesave dhe infrastrukturës.



Nëpërmjet këtij projekti janë mundësuar zhvillimi i dy karriera të lidhura me fabrikën e çimentos, ndërtimi i rrugëve të reja dhe infrastrukturës mbështetëse si dhe zhvillimi i transportit dhe logjistikës. Për më tepër, zbatimi i këtij projekti ka dhënë kontribut në zhvillimin dhe funksionimin e Laboratorit Teknik për Trajnimet Profesionale, i cili është krijuar dhe certifikuar sipas standarteve kombëtare në Shkollën Publike të Komunës Thumanë.

Përpara fillimit të këtij projekti u krye një Studim për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social, në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira për të siguruar që të merren parasysh dhe të adresohen të gjithë ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale, ndërkohë që konsultimet me publikun rrisin transparencën dhe besueshmërinë ndërmjet grupeve të interesit të përfshira në projekt.

Përfitimet nga projekti i ANTEA-s.

- » Çimento është përbërësi kryesor i betonit, materiali që përdoret më tepër në fushën e ndërtimit në mbarë botën.
- » 200 pozicione pune me kohë të plotë janë ofruar për tregun vendas ndërkohë që janë krijuar më shumë se 200 pozicione pune për palët e treta dhe në veçanti për kontraktorë dhe furnizues të fabrikës.
- » Prodhimi në vend i materialeve të ndërtimit ul nevojën për të importuar dhe rrit dukshëm mundësinë për eksportimin e çimentos tek vendet e tjera.
- » Investimet e reja që operojnë në mënyrë të suksesshme në tregjet e reja dhe zhvilluese, sipas standarteve ndërkombëtare, shërbejnë për të tërhequr investime të tjera dhe krijojnë efekte të shumavlerëshme për periudhën afatgjatë.
- » Infrastruktura e re, duke përfshirë qendrën e trajnimeve profesionale dhe ndërtimin e rrugëve të reja rrit kapacitetin për zhvillim të mëtejshëm në rajon dhe ofron mundësi të reja për ndërtimin e karrierës profesionale.

Bashkëpunimi i Grupit TITAN me IFC dhe BERZH

Projekti ANTEA është krijuar nga Grupi TITAN dhe ka tërhequr që herët interesin e Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC/ Grupi i Bankës Botërore) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Në muajin nëntor të vitit 2008 dy bankat bashkuan forcat me Grupin TITAN dhe nënshkruan një kontratë për pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë bijë të Grupit TITAN në Shqipëri si dhe financimin me kredi të saj.

Zhvillimi i Projektit ANTEA si një ndërmarje e përbashkët, jo vetëm mbron qëndrueshmërinë e projektit në një periudhë që ndikohet shumë nga rënia ekonomike në mbarë botën, por rrit në të njëjtën kohë pritshmërinë për aplikimin e standarteve më të larta ndërkombëtare, të cilat janë përfshirë në strategjitë, vlerat dhe praktikatat e të tre aksionerëve të këtij projekti.



Një pasqyrim i TITAN Group




Ndërtimi i një fabrike të re për prodhimin e çimentos

Projekti për ndërtimin e një fabrike të re për prodhimin e çimentos u realizua nga Grupi kinez SINOMA, i specializuar në këtë fushë, me prezencë dhe eksperiencë të mëparshme në Shqipëri. Në këtë projekt u ftuan kompani vendase për të kryer të gjithë veprimtaritë e tjera të nevojshme duke përfshirë gërmimet, transportimin, sigurinë, logjistikën, etj. Më shumë se 1.000 njerëz kanë punuar për

18 muaj rresht për të përfunduar fabrikën e re, e cila është projektuar sipas standarteve më të larta të cilësisë, mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë.

Punimet për ndërtimin e fabrikës së re në Shqipëri filluan në maj 2008. Në të njëjtën kohë, u hapën tre zyra informacioni publike në Tiranë, në Bashkinë e Krujës dhe në Komunën Thumanë për të informuar të gjithë palët e interesuara



Fabrika e re e çimentos TITAN në Shqipëri 2010

mbi këtë projekt. Për më tepër, u krijua një faqe interneti dedikuar ANTEA-s ku vihen në dispozicion të gjithë materialet dhe informacioni lidhur me projektin dhe analiza të plota të standarteve mjedisore dhe sociale, të cilat zbatohen nga TITAN në Shqipëri.

Një kompani konsulence e specializuar në bashkëpunim me zyrtarë të kualifikuar të kompanisë morën

përgjegjësinë për të organizuar dhe për të komunikuar programin e punësimit për të gjithë pozicionet e punëve në Shoqërinë ANTEA. Gjatë fazës së ndërtimit të gjitha përpjekjet e TITAN-it u përqëndruan në ruajtjen e sigurisë, ndërsa hidheshin themelet për funksionimin e fabrikës së çimentos. Para fillimit të ndërtimeve u hartuan udhëzime dhe procedura për të gjithë palët dhe punonjësit e

përfshirë në projekt, ndërkohë që shumë trajnime u zhvilluan në ambientet e Komunës Thumanë me qëllim për t'i pajisur punonjësit me aftësi dhe kompetenca të reja që nevojiten në punën e tyre. Vetëm në vitin 2009 më shumë se 10.000 orë u shpenzuan për trajnimin e punonjësve të TITAN-it ndërkohë që u shpenzuan 265.000 € për trajnimet e ofruara nga organizata evropiane dhe vendase.



Siguria, kujdesi për mjedisin dhe angazhimi i grupeve të interesit të përfshirë në këtë projekt

Që në fazat e hershme, TITAN caktoi një Komitet Drejtues të nivelit të lartë që do të merrej me koordinimin e projektit të ANTEA-s, në bashkëpunim me ekspertët e fushës së sigurisë, sociale dhe mjedisore. Rëndësi e veçantë iu kushtua trajnimit dhe mbështetjes së punonjësve, kontraktorëve dhe furnizuesve për të përfituar dhe integruar të gjitha politikat dhe praktikatat e nevojshme në lidhje me parandalimin e aksidenteve brenda dhe jashtë sheshit të ndërtimit të fabrikës, trajtimit të ndershëm dhe të bazuar në ligj për punonjësit, komunitetet vendase dhe të tjerë grupe interesi. Vendosja e sigurisë si prioritet në marrëdhëniet e TITAN-it me kontraktorët dhe furnizuesit kryesorë kishte si qëllim integrimin e një koncepti sigurie, i cili përveç shqetësimit për ndërtimet, do të fokusohet edhe në risqet e mundshme gjatë funksionimit të fabrikës në të ardhmen.



Grupi TITAN është një prodhues i materialeve të ndërtimit, i pavarur dhe shumë-rajonal, me një eksperiencë 100 vjeçare në fushën e industrisë. Grupi e ka selinë në Greqi dhe sot operon në 7 vende, ku zotëron 12 fabrika për prodhimin e çimentos. I fokusuar në kombinimin e eksperiencës operationale me respektin ndaj njerëzve, shoqërisë dhe mjedisit, TITAN-i bën pjesë në grupin e 500 kompanive të para që kanë nënshkruar Iniciativën "Global Compact" të OKB-së dhe një anëtar i rëndësishëm i Iniciativës së Prodhimit të Qëndrueshëm të Çimentos, e cila operon nën kujdesin e Këshillit Botëror të Biznesit për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Që në fillim të zbatimit të projektit të ANTEA-s u zhvilluan takime, me objekt shkëmbimin e informacionit dhe konsultimet me grupet kryesore të interesit dhe në veçanti me komunitetet vendase dhe banorë nga fshatrat fqinje, OJQ, autoritete qeveritare, media dhe të tjerë. Këto takime, ku vetëm në vitin 2009 numërohen 200, kanë ndihmuar në ndërtimin e marrëdhënieve me aktorët e përfshirë në projekt, bazuar në transparencë dhe sinqeritet.

Komiteti Lokal Ndërlidhës që përbëhet nga përfaqësues të palëve të interesuara, në nivel lokal, mbledhet rregullisht për të diskutuar mundësi të reja për veprime dhe veprimtari të përbashkëta me qëllim zhvillimin e komunitetit.

Së fundmi por jo më pak e rëndësishme, drejtuesit e TITAN-it kanë përgatitur dhe prezantuar tek grupet lokale të interesit një Plan Social për Komunitetin, për të udhëhequr parandalimin, zbutjen dhe kontrollin e ndikimeve të mundshme sociale tek komunitetet vendore, si dhe shfrytëzimin e mundësive për përmirësimin e kushteve sociale në rajonin rreth fabrikës. Plan Social për Komunitetin është aktualisht nën zbatim dhe do të shtrihet edhe për dy vite të tjera.....



ANTEA buletini

ANTEA Cement Sh.A.
Kashar, Katundi i Ri,
Autostrada Tiranë-Durrës,
Km. 7, PO BOX 1746
Tiranë, Shqipëri

ANTEA
Tel: + 355 (0) 44 50 2427
Fax: + 355 (0) 44 50 2412
E-mail: info@anteacement.al

Informacion me te detajuar mund ta gjeni ne faqet e internetit:

www.anteacement.com . www.titan-cement.com . www.lfc.org . www.ebrd.com